

PROCESVERBAL
nga vazhdimi i seancës së 8-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 04.03.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, dr.Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, Maja Damevska .

Të pranishmit e tjerë : /

Z. Petrushevski hapi vazhdimin e parë të seancës së 8-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 19:15 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Z. Petrushevski sqaroi se në seancë do të shqyrtohet nënpika e pikës 4 - Propozimi për heqjen e lejes për radiotransmetim, nr.08-105 datë 07.09.2023 të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion RADIO USKANA – PLUS eksport-import SHPKNJP Kërçovë.

Z. Trajçevski propozoi, meqënëse Agjencia dhe Këshilli veprojnë në mënyrë të njëjtë për të gjithë transmetuesit, nëse RA USKANA-PLUS arrin gjatë ditës së nesërme të zhbllokojë llogarinë në bashkëpunim me SHMDMA dhe nëse i paguan faturën Agjencisë, Këshilli të njëjtën ditë duhet të mbajë seancë për të marrë vendim për kthimin e lejes.

Z. Petrushevski u pajtua me propozimin dhe tha se do të bëhen të gjitha përpjekjet për t'i kthyer lejen.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio, nr. 08-105 datë 07.09.2023 të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO USKANA – PLUS eksport-import SHPKNJP Kërçovë, për shkak të mos pagesës së kompensimit vjetor për lejen për transmetim në radio në afatin e përcaktuar ligjor – 30 ditë nga dita e pranimit të faturës nr.2024-100-0058 datë 11.01.2024 (nr.ynë ark.0503-227/1 datë 11.01.2024).

Spektori për përkrahje të punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm ta publikon në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", në ueb faqen e Agjencisë dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra në gjuhën e bashkësive joshumicë dhe që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pika Të ndryshme

Z. Petrushevski sqaroi se ka një lajm pozitiv, TV Shutel ka arritur të paguajë faturën për kompensimin vjetor të lejes. Në këtë drejtim, propozohet që Këshilli të miratojë Vendim me të cilin anulohet Vendimi për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup.

Z. Trajçevski sqaroi se transmetuesi të premtën i ka paguar paratë në llogarinë e Agjencisë, por ato nuk janë paguar nga llogaria e tij, por nga firmë tjetër në emër të tij. Duke qenë se dy ditët në vijim ishin vikend dhe ai nuk mundi të kryente pagesën të shtunën dhe të dielën, mëngjesin e sotëm në marrëveshje me SHMDMA iu zhblllokua llogaria dhe në gjysmën e parë të ditës së sotme mjetet janë paguar në tërësi nga llogaria e transmetuesit. Duke pasur parasysh se vendimi për heqjen ende nuk është publikuar në Gazetën Zyrtare të RMV-së, pasi që vendimi është marrë të premtën pasdite, propozohet të merret Vendim me të cilin anulohet në tërësi Vendimi i Këshillit të Agjencisë PA1 nr.0803 -56 datë 04.03.2024 për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqatës Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim me të cilin anulohet Vendimi i Këshillit të Agjencisë PA1 nr.0803-56, datë 03.04.2024 për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, PA1 08-18 datë 07.09.2024, për shkak se transmetuesi në tërësi e ka përmbushur detyrimin ligjor për pagesën e kompensimit vjetor për lejen e transmetimit televiziv, në pajtim me faturën e dhënë me nr. 2024-100-0011 datë 11.01.2024 (nr. ynë ark. 0503-172/1 datë 11.01.2024).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**